

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11) dhe në bazë të nenit 25 paragrafi 2 dhe paragrafi 5 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 103/08, 33/2010, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12 dhe 24/13), si dhe në bazë të nenit 6 dhe neni 7, paragrafi 1, alineja 4 të Ligjit për zhvillimin e arsimit („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 37/06, 142/08, 148/09, 69/13, 120/13, 148/13), ministri i Arsimit dhe Shkencës e caktoi Programin mësimor për *shkencat natyrore* për klasën e I në arsimin fillor nëntëvjeçar.

CambridgeInternationalExamination

Byroja e zhvillimit të arsimit

PROGRAM MËSIMOR

SHKENCAT NATYRORE

për klasën e I

Arsimi fillor nëntëvjeçarë

Shkup, shkurt 2014

Hyrje

Programi mësimor i *shkencave natyrore* për klasën e parë në arsimin fillor nëntëvjeçar është marrë nga Qendra Ndërkombëtare e programeve mësimore (Cambridge International Examination) dhe adaptuar nga Byroja e zhvillimit të arsimit. Lejimi i adaptimit të programeve mësimore është marrë nga ekspertë të Qendrës Ndërkombëtare të programeve mësimore (Cambridge International Examination).

Programi mësimor ngërthen në vete përmbledhje të qëllimeve zhvillimore mësimore nga lëmi i shkencave natyrore. Në to hollësisht bëhet përshkrimi çka duhet të dijë nxënësi ose çka do të duhej të mund të bëjë për çdo vit në arsimin fillor. Objektivat mësimore sigurojnë strukturë për mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe rekomandim për të cilat aftësitë dhe njohuritë e nxënësit mund të kontrollohen.

Programi mësimor i shkencave natyrore për arsimin fillor në katër lëmit përmbajtjesore: hulumtim shkencor, biologji, kimi dhe fizikë. Hulumtimi shkencor përfshin shqyrtimin e ideve, vlerësimin e dëshmive, planifikimin e punës hulumtuese dhe evidentimin dhe analizën e të dhënave. Hulumtimi shkencor i përforcon: biologjinë, kiminë dhe fizikën të cilat, gjithashtu, janë të fokusuara në zhvillimin e vetëbesimit dhe interesimit për arritje të njohurive shkencore.

Programi mësimor duhet të realizohet me fond prej 2 orë në javë, përkatësisht 72 orë në vit.

Pjesët nga programi mësimor që kanë të bëjnë me vlerësimin, kushtet hapësinore për realizimin e mësimimit dhe normativin për kuadrin mësimor janë dhënë në mënyrë plotësuese në pajtim me nenin 25 paragrafi 5 të Ligjit për arsim fillor.

Program mësimor për klasën e I

1. Lëmit dhe rezultatet e pritura

Hulumtim shkencor

Ide dhe dëshmi:

- përpiqet të përgjigjet në pyetjen duke mbledhur dëshmi përmes vëzhgimit.

Planifikimi i punës hulumtuese:

- parashtron pyetje dhe merr pjesë në diskutime për të arritur te përgjigja përkatëse;
- parashikon;
- vendos çka të bëjë që të përgjigjet në pyetjen hulumtuese.

Marrja dhe paraqitja e dëshmive:

- hulumton, vëzhgon dhe mbledh dëshmi (matje dhe vëzhgime) për t'u përgjigjur pyetjes;
- propozon ide dhe i ndjek udhëzimet;
- evidenton fazat e punës.

Shqyrtimi i dëshmive dhe qasjet:

- bën krahasime;
- i krahason parashikimet me rezultatet e fituara;
- krijon ide dhe debaton për ato me qëllim që ti ndajë, sqarojë dhe zhvillojë ato.

Biologji

Bimët:

- di se bimët janë të gjalla;
- di se ekzistojnë gjëra të gjalla të cilat asnjëherë nuk kanë qenë të gjalla;
- hulumton mënyra në të cilat shtazët dhe bimët e ndryshme i popullojnë mjediset lokale vendore;
- emërton pjesë kryesore të bimëve, duke vërejtur në bimë dhe modele të vërteta;
- di se bimëve iu nevojitet drita dhe ajri për rritjen e tyre;
- hulumton si nga fara zhvillohen bimët.

Njerëz dhe kafshë:

- njeh dallimet dhe ngjashmëritë;
- njeh dhe emërton pjesët kryesore të jashtme të trupit;
- di për nevojën e të ushqyerit të shëndetshëm, e cila përfshin ushqim të llojlojshëm dhe ujë;
- hulumton se si përmes shqisave njerëzit dhe kafshët bëhen të vetëdijshëm për botën rreth tyre;
- di se njerëzit dhe kafshët krijojnë breza të rinj të cilët rriten me të mëdhenjtë.

Kimia

Vetitë e materialeve:

- shfrytëzon shqisat për të hulumtuar dhe të sqarojë për materialet e ndryshme;
- i identifikon karakteristikat e materialeve të ndryshme;
- njeh dhe emërton materiale nga jeta e përditshme;
- klasifikon gjësende në grupe në bazë të vetive të materialeve prej të cilëve janë bërë.

FIZIKA

Fuqitë:

- hulumton, bisedon dhe përshkruan lëvizjen e gjësendeve të njohura;
- njeh fuqi të shtyrjes dhe tërheqjes;
- njeh për gjërat që përshpejtohen, ngadalësojnë ose e ndryshojnë drejtimin, ekziston shkak për këto.

Zë:

- identifikon shumë burime të tingujve;
- di se dëgjojmë kur zëri depërton në veshin tonë;
- njeh se zëri më pak dëgjohet kur largohet nga burimi.

2. Objektivat konkrete, veprimtaritë dhe mjetet për punë

Objektivat në Programin mësimor të shkencave natyrore janë grupuar në gjashtë njësi tematike të cilat janë dhënë sipas radhitjes së caktuar, por lirisht mund të realizohen me nxënësit ashtu siç ofrojnë kushtet lokale, mjetet dhe materialet për mësim.

Objektivat e hulumtimit shkencor përsëriten, paraqiten në secilën temë dhe si të tilla janë të shënuara veçmas në fillim të secilës temë.

Në programin mësimor për klasën e parë ka gjashtë tema të cilat mundësojnë gradualisht mësim nxënien e përmbajtjeve mësimore nga biologjia, kimia dhe fizika. Veprimtaritë dhe resurset (mjetet dhe materialet) janë propozuar sipas objektivave të dhëna të mësimit për të paraqitur metoda dhe veprimtari të mundshme për realizim të suksesshëm të programit.

Ne	Të jetuarit dhe rritja	Prodhimi i tingujve
Prej çka është bërë?	Shtyrje dhe tërheqje	Kultivimi i bimëve

Ne

Në këtë temë nxënësit mësojnë se njerëzit dhe organizmat tjerë të gjallë lëvizin dhe rriten.

Ato, gjithashtu, mësojnë për shqisat e tyre, dhe si mund ti shfrytëzojnë për ta hulumtuar botën rreth tyre.

Hulumtimi shkencor fokusohet në:

- mbikëqyrjen dhe përshkrimin e qenieve të gjalla dhe bisedë për atë që ka ndodhur;
- hulumtimin dhe shfrytëzimin e shqisave ;
- mundësinë për të menduar për atë se si të kujdesen ndaj qenieve tjera të gjalla.

Objektivat e mësimit	Nocionet
<p>Ide dhe dëshmi: - përpiqet t'i përgjigjet pyetjes duke grumbulluar dëshmi përmes vëzhgimit.</p> <p>Planifikimi për punën hulumtuese: - parashtron pyetje dhe merr pjesë në diskutim për ta gjetur përgjigjen; - parashikon; - vendos çka të bëjë për t'u përgjigjur pyetjes shkencore.</p> <p>Marrja dhe parashtrimi i dëshmive: - hulumton, vëzhgon dhe grumbullon dëshmi (matje dhe vëzhgime) për t'u përgjigjur pyetjes; - propozon dhe i ndjek udhëzimet; - evidenton faza të punës.</p>	<p>Njeri Kafshë Lëvizje Rritje Shqisa-lloji, prekje/ndjenjë, shije, aromë, dëgjim/të dëgjuarit Koka – sytë, veshët, hunda, goja, floku Trupi Dora - supet Këmbët - gjunjët Shputat- gishtërinjtë e këmbës</p> <p>Hulumtim shkencor Përshtat (parashikon) Krahason</p>
<p>Shqyrtimi i dëshmive dhe qasjet: - bën krahasime; - i krahason parashikimet me rezultatet e fituara; - krijon dhe diskuton për to me qëllim që ti krahasojë, sqarojë dhe zhvillojë.</p>	

Objektivat e mësimxënies	Veprimtaritë	Resurset (mjete dhe materiale)	Komentet
Njerëz			
Njeh dallimet dhe ngjashmëritë të njerëzimit	Grumbulloni të dhëna, për shembull ngjyra e syve, numëroni dhe sqaroni.	Burime sekondare (libra, CD, Internet)	Shkathtësitë vlerësuese për hulumtime shkencore.
Njeh dhe emërton pjesët kryesore dhe të jashtme të trupit.	Luani lojëra që ka të bëjë me këtë përmbajtje (për shembull loja: Simon Says).	Shih http://en.wikipedia.org/wiki/Simon_says	
Hulumton si shqisat iu mundësojnë njerëzve dhe gjallesave tjera të jenë të vetëdijshme për botën rreth tyre.	Prezantoni shqisat duke shfrytëzuar këngë me rimë. Lloji - thjerrëz Dëgjimi – tinguj të CD Aromë – ushqim/parfume Ndjenjë – „strajcë për prekje“ Shije – e njelmët/e ëmbël	CD – këngë/rima Thjerrëz Ushqim/parfume „Strajcat për prekje“	

Prej çka është bërë?

Në këtë temë nxënësit mësojnë për karakteristikat dhe përdorimin e materialeve të ndryshme të njohura. Ato njoftohen me fjalorin shkencor që përdoret për përshkrimin dhe për krahasimin e materialeve.

Objektivat e mësimnxënies	Nocionet
<p>Ide dhe dëshmi:</p> <ul style="list-style-type: none">- përpiqet t'i përgjigjet pyetjes duke grumbulluar dëshmi përmes vëzhgimit. <p>Planifikimi për punën hulumtuese:</p> <ul style="list-style-type: none">- parashtron pyetje dhe merr pjesë në diskutim për ta gjetur përgjigjen;- parashikon;- vendos çka të bëjë për t'u përgjigjur pyetjes shkencore. <p>Marrja dhe parashtrimi i dëshmive:</p> <ul style="list-style-type: none">- hulumton, vëzhgon dhe grumbullon dëshmi (matje dhe vëzhgime) për t'u përgjigjur pyetjes;- propozon dhe i ndjek udhëzimet;- evidenton faza të punës. <p>Shqyrtimi i dëshmive dhe qasjet:</p> <ul style="list-style-type: none">- bën krahasime;- i krahason parashikimet me rezultatet e fituara;- krijon dhe diskuton për to me qëllim që ti krahasojë, sqarojë dhe zhvillojë.	<p>Materialet për shembull:</p> <ul style="list-style-type: none">- dru- letër- qelq- plastikë- metal <p>(dhe të gjitha materialet tjera relevante që iu janë parashtruar).</p> <p>Hulumtim shkencor:</p> <ul style="list-style-type: none">- pyet- shikon- zgjedh- zbulon- tregon- shkruan- rrëfen/shqipton- vizaton- krahason- qëllon (paragjykon)- ndanë.

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurset (mjete dhe materiale)	Komentet
Përbërja e materialeve			
Përdor shqisa për të hulumtuar dhe diskutuar për materiale të ndryshme.	„Strajcat për prekje“ Lojë me sy të mbyllur Kërkimi i materialit	Strajcë për prekje	Disa fëmijë kanë frikë ti mbyllin sytë e tyre, për këtë arsye çdo herë kërkoni mendimin apo pëlqimin e tyre.
Identifikon karakteristikat e materialeve të ndryshme.	Shqyrtimi i koleksionit prej materialeve të ndryshme.	Koleksion i materialeve dhe gjësendeve të ndryshme të bëra nga materialet e njëjta.	Ndonjëherë ekziston konfuzion se qimja e tekstitit është material. Vlerësoni shkathtësitë për vetëvlerësim.
Njih dhe emëron materiale të njohura.	Shqyrtimi i koleksionit prej materialeve të ndryshme.	Koleksion i materialeve dhe gjësendeve të ndryshme të bëra nga materialet e njëjta.	
Klasifikon gjësende në grupe sipas përbërjes së materialeve të tyre.	Lejoni fëmijët ti zbulojnë grupimet e tyre dhe të japin sqarime.	Hullahop, litar	

Të jetuarit dhe rritja

Me këtë temë nxënësit njihen me bimët si qenie të gjalla të cilat rriten dhe ndryshojnë.

Nxënësit vetëdijesohen për ngjashmëritë dhe dallimet te bimët.

Objektivat e mësimnxënies	Nocionet
<p>Ide dhe dëshmi:</p> <ul style="list-style-type: none">- përpiqet t'i përgjigjet pyetjes duke grumbulluar dëshmi përmes vëzhgimit. <p>Planifikimi për punën hulumtuese:</p> <ul style="list-style-type: none">- parashtron pyetje dhe merr pjesë në diskutim për ta gjetur përgjigjen;- parashikon;- vendos çka të bëjë për t'u përgjigjur pyetjes shkencore. <p>Marrja dhe parashtrimi i dëshmive:</p> <ul style="list-style-type: none">- hulumton, vëzhgon dhe grumbullon dëshmi (matje dhe vëzhgime) për t'u përgjigjur pyetjes;- propozon dhe i ndjek udhëzimet;- evidenton faza të punës. <p>Shqyrtimi i dëshmive dhe qasjet:</p> <ul style="list-style-type: none">- bën krahasime;- i krahason parashikimet me rezultatet e fituara;- krijon dhe diskuton për to me qëllim që ti krahasojë, sqarojë dhe zhvillojë	<p>Kafshë Kafshë përkëdhelëse Bimë shtëpiake E gjallë Fermë Jo e gjallë Njeri Ushqim Familje Ujë Ha Ajër Pi</p> <p>Hulumtimi shkencor:</p> <ul style="list-style-type: none">- pyet/shqipton/tregon- përgjigjet- qëllon (paragjykon)- vëren- krahason- ndan.

Objektivat e mësimxënies	Veprimtaritë	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
Di se kafshët dhe bimët janë qenie të gjalla.	Vizatoni/bëni model nga shfaqja Juaj e kafshëve dhe bimëve.		
Di se ekzistojnë qenie të gjalla dhe gjëra që nuk janë të gjalla.	Zgjedh fotografi të organizmave të imët/ gjësendeve të vdekura Zgjedh bimë të vërteta kundrejt bimëve artificiale. Shëtitje shkencore (mësim në natyrë), grumbulloni qeni të gjalla/jo të gjalla.	Zgjedh bimë të vërteta dhe artificiale.	Ofroni siguri gjatë realizimit të veprimtarive
Hulumton mënyra në të cilat gjallesa dhe bimë të ndryshme jetojnë në mjedisin lokal jetësor.	Shëtitje shkencore (mësim në natyrë).		
Mëson rreth nevojës për ushqim të shëndetshëm, të ushqyerit e rregullt dhe shfrytëzimi i ujit.	Diskutoni nevojën për ushqim dhe pirje. Tregoni fotografi nga kafshë të njohura përkëdhelëse dhe diskutoni . Njihuni me bimët ushqyese, si për shembull: molla, domatja, gruri, lakra.	Mund t'iu tregohet për paketimin e ushqimit në klasë dhe lojëra të ndërlidhura me ushqimin.	Ndjeshmëria e ushqimit mund të diskutohet nëse përmendet nga vetë nxënësit.
Di se njerëzit dhe kafshët japin pasardhës të cilët më pas rriten.	Vizitë në fermë që të shihen qeniet e porsalindura. Krahasimi i fotografive familjare lidhur me rritjen e tyre dhe rritjen e anëtarëve tjerë të familjes.	Organizim i vizitës në fermë (vlerësimi i rrezikut, personeli i inkuadruar, shpenzimet, transporti, sigurimi, leje nga prindërit). Kërkoni nga fëmijët të sjellin fotografi nga anëtarët e familjes.	Harmonizim me programin shkollor për vizitat arsimore.

Shtyrje dhe tërheqje

Në këtë temë nxënësit mësojnë se shtyrja dhe tërheqja ndodhin nën ndikimin e fuqisë.

Ato mësojnë për llojet e ndryshme të lëvizjeve dhe si ti përshkruajnë ato.

Ato, gjithashtu, mësojnë të përgjigjen në kuptimin e tyre të lëvizjes në kontekstet e përditshmërisë, për shembull siguri në rrugë.

Objektivat e mësimnxënies	Nocione
<p>Ide dhe dëshmi:</p> <ul style="list-style-type: none">- përpiket t'i përgjigjet pyetjes duke grumbulluar dëshmi përmes vëzhgimit. <p>Planifikimi për punën hulumtuese:</p> <ul style="list-style-type: none">- parashtron pyetje dhe merr pjesë në diskutim për ta gjetur përgjigjen;- parashikon;- vendos çka të bëjë për t'u përgjigjur pyetjes shkencore. <p>Marrja dhe parashtrimi i dëshmive:</p> <ul style="list-style-type: none">- hulumton, vëzhgon dhe grumbullon dëshmi (matje dhe vëzhgime) për t'u përgjigjur pyetjes;- propozon dhe i ndjek udhëzimet;- evidenton faza të punës. <p>Shqyrtimi i dëshmive dhe qasjet:</p> <ul style="list-style-type: none">- bën krahasime;- i krahason parashikimet me rezultatet e fituara;- krijon dhe diskuton për to me qëllim që ti krahasojë, sqarojë dhe zhvillojë.	<p>Lëviz/lëvizje/lëvizje Luhatet Rrotullohet Shpejt/më shpejtë /shumë shpejtë Ngadalë/më ngadalë/shumë ngadalë Ndalon</p> <p>Hulumtim shkencor:</p> <ul style="list-style-type: none">- pyet- përgjigjet- flet për/ndanë- qëllon (paragjykon)- shikon /vështron- zbulon- tregon- shkruan/vizaton- krahason.

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurset (mjete dhe materiale)	Komentet
Hulumton, bisedon dhe përshkruan lëvizjen e gjësendeve të njohura.	Shëtisni në terren sportiv/park lokal. Shqyrtimi i komunikacionit – shpejtësia. Arsimi fizik – hulumtoni lëvizjet e ndryshme të trupit; lëkundje, rrotullim, rrotullim në rreth, shpejtë, më ngadalë.		Disa fëmijë vetë e njohin lëvizjen, si lëvizin nga një vendi në vend tjetër.
Njih se shtyrja dhe tërheqja paraqesin forcë.	Kërkoni në klasë lodra që lëvizin. Parashikoni si ato do të mund të lëvizin, të përshpejtohen, të ngadalësohen dhe/ose të ndalen.	Zgjedhje e lodrave lëvizëse.	
Njohje kur gjësendet përshpejtohen, ngadalësohen ose e ndryshojnë kahen, ekziston arsye për këtë.	Vëzhgimi i gjësendeve që lëvizin: Në erë Rrotë në erë Rrotë në ujë Flluska që pëlçasin. Diskutoni arsyet për këto lëvizje.	Pajisje për lojë me rërë dhe ujë. Lëng për bërjen e flluskave dhe shkopinj për të fryrë flluskat .	Era i lëvizë degët e druve dhe ato nuk lëvizin vetë.

Prodhimi i tingujve

Kjo temë iu mundëson nxënësve ta zhvillojnë kuptimin e tyre për llojllojshmërinë e madhe të tingujve dhe burimeve të tingujve me të cilat ato i hasin në përditshmëri.

Ato duhet të fillojnë ti ndërlidhin tingujt me kuptimin e tyre të dëgjimit.

Ato njoftohen me idenë se tingujt udhëtojnë nga burimi.

Objektivat e mësimnxënies	Nacionet
<p>Ide dhe dëshmi:</p> <ul style="list-style-type: none">- përpiqet t'i përgjigjet pyetjes duke grumbulluar dëshmi përmes vëzhgimit. <p>Planifikimi për punën hulumtuese:</p> <ul style="list-style-type: none">- parashtron pyetje dhe merr pjesë në diskutim për ta gjetur përgjigjen;- parashikon;- vendos çka të bëjë për t'u përgjigjur pyetjes shkencore. <p>Marrja dhe parashtrimi i dëshmive:</p> <ul style="list-style-type: none">- hulumton, vëzhgon dhe grumbullon dëshmi (matje dhe vëzhgime) për t'u përgjigjur pyetjes;- propozon dhe i ndjek udhëzimet;- evidenton faza të punës. <p>Shqyrtimi i dëshmive dhe qasjet:</p> <ul style="list-style-type: none">- bën krahasime;- i krahason parashikimet me rezultatet e fituara;- krijon dhe diskuton për to me qëllim që ti krahasojë, sqarojë dhe zhvillojë.	<p>Tingull Zë I zërit I butë I heshtur Dëgjim/të dëgjuarit Veshët Dëgjimi</p> <p>Hulumtim shkencor:</p> <ul style="list-style-type: none">- flet për...- parashtron (pyetje)- dëgjon- qëllon (paragjykon)- shikon- zbulon- shkruan/vizaton- emëron- tregon- shpjegon/flet, krahason.

Objektivat e mësimnxënies	Veprimtaritë	Resurset (mjete dhe materiale)	Komente
Identifikon më shumë burime të tingullit.	<p>Diskutoni për tingujt që mund ti bëjnë me zërin/trupin e tyre.</p> <p>Dëgjoni tinguj të ndryshëm të kafshëve.</p> <p>Këndimi i këngëve dhe rima duke përfshirë edhe tinguj të kafshëve.</p> <p>Dëgjim duke shkuar në shkollë-identifikimi i tingujve.</p> <p>Kuis për tinguj.</p> <p>Përdorimi i instrumenteve muzikore.</p>	<p>CD përshkrime/Internet – tinguj të kafshëve.</p> <p>Incizoni çdo ditë tinguj për identifikim në kuisin me tinguj- duke përfshirë tinguj të njohur.</p> <p>Instrumente muzikore.</p>	<p>Fëmijët me dëgjim të dëmtuar do të kenë nevojë për përkrahje të veçantë gjatë kësaj njësie, për shembull paraqitje vizuale të instrumenteve muzikore.</p> <p>Mësimdhënësit duhet të jenë të sigurtë se fëmijët tjerë janë të ndjeshëm ndaj fëmijëve me dëgjim të dëmtuar.</p>
Njih se me largimin e tingullit nga burimi, bëhet më i paqartë.	<p>Dëgjimi i tingujve përderisa largohet nga burimi.</p> <p>Diskutim për borinë e automjeteve për ndihmën e shpejtë.</p>	<p>Klasë e madhe, për shembull sallë e shkollës.</p> <p>Instrumente muzikore.</p> <p>Vizitë e mundshme nga shërbimet e ndihmës së shpejtë. Lidhshmëri me punën sociale dhe mjekësore.</p>	
Shqyrton se ne dëgjojmë kur tingulli depërton në veshin tonë.	<p>Krahasimi i tingujve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - me/pa mbajtjen e dëgjueseve; - me sy të mbyllur; - me shfrytëzimin vetëm të njërit vesh. <p>Diskutoni për sigurinë e rrugës.</p>	<p>Mbrojtës për veshë.</p> <p>Posterë (pllakat) për siguri në rrugë.</p> <p>Lojëra për siguri në rrugë.</p>	<p>Vlerësimi – rrëfeni tregim duke përfshirë mundësitë që fëmijët të marrin pjesë me zbatimin e efekteve të tingujve.</p>

Kultivimi i bimëve

Kjo temë i njofton nxënësit me bimët si qenie të gjalla.

Ato, gjithashtu, mësojnë se bimët rriten dhe përmes rritjes ato ndryshojnë.

Nxënësit bëhen të vetëdijshëm për ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet bimëve.

Ekzistojnë mundësi për lidhshmërinë e njohurive të tyre për rritjen e bimëve me kuptimin e tyre ndaj shkencës.

Njoftohen dhe iu jepen ide si të sillen ndaj bimëve që rriten.

Objektivat e mësimnxënies	Nocione
<p>Ide dhe dëshmi:</p> <ul style="list-style-type: none">- përpiqet t'i përgjigjet pyetjes duke grumbulluar dëshmi përmes vëzhgimit.	Bimë Gjeth/gjethë Kërçelli Rrënja Lulja
<p>Planifikimi për punën hulumtuese:</p> <ul style="list-style-type: none">- parashtron pyetje dhe merr pjesë në diskutim për ta gjetur përgjigjen;- parashikon;- vendos çka të bëjë për t'u përgjigjur pyetjes shkencore.	Fara Rritja Bimë Drita Uji
<p>Marrja dhe parashtrimi i dëshmive:</p> <ul style="list-style-type: none">- hulumton, vëzhgon dhe grumbullon dëshmi (matje dhe vëzhgime) për t'u përgjigjur pyetjes;- propozon dhe i ndjek udhëzimet;- evidenton faza të punës.	Hulumtim shkencor:
<p>Shqyrtimi i dëshmive dhe qasjet:</p> <ul style="list-style-type: none">- bën krahasime;- i krahason parashikimet me rezultatet e fituara;- krijon dhe diskuton për to me qëllim që ti krahasojë, sqarojë dhe zhvillojë.	<ul style="list-style-type: none">- pyet- përgjigjet- shpjegon/flet- qëllon (paragjykon)- shkruan/vizaton- krahason- ndanë- mundëson kushte të njëjta Për hulumtim.

Objektivat e mësimxënies	Veprimtaritë	Resurset (mjete dhe materiale)	Komentet
Emëron pjesët kryesore të një bime, duke parë bimë të vërteta dhe modele.	Tregohen rrënjët e mbjella në saksi. Shfrytëzon bimë të vërteta dhe artificiale.	Bimë në saksi me rrënjë të forta. Bimë të vërteta dhe artificiale.	Paraprakisht të përgatitur.
Hulumton si farat rriten në bimë që lulëzojnë.	Kultivimi i farave të bimëve dhe rritja e tyre (për shembull luledielli, kungulli dhe fasulja etj.).	Fara, dheu për rritje, saksia etj. Vegël për kopshtari.	
Di se bimët për tu rritur kanë nevojë për dritë dhe ujë.	Rritja e bimës sipas zgjedhjes , gjysma e tyre në errësi dhe gjysma në dritë. Realizimi i tentativës për ringjalljen e bimëve të vyshkura.	Fara nga bimë të ndryshme (fasule, grurë etj.)	Shfrytëzoni bimë të rritur nëse nuk keni kohë ta rrisni atë.

3. Vlerësimi i të arriturave të nxënësve

KONTROLLIMI DIAGNOSTIK DHE VLERËSIMI

Në fillim të vitit shkollor mësimmshënësi bën kontrollimin diagnostik dhe vlerësimin e nxënësve me qëllim të dijë gjendjen në funksion të cilësisë së planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve të ardhshme. Kuptohen njohuritë paraprake të kuptim të gjerë të fjalës, aspektet socializuese të zhvillimit, zhvillimi emocional dhe zhvillimi fizik.

VLERËSIMI FORMATIV- Në rrjedhën e mësimmshënësis nga shkencat natyrore në klasën e parë rekomandohet ndjekja formative e cila përfshin përpunimin dhe udhëheqjen e shumë provave të nxënësve që përfshinë:

- mbledhjen e treguesve për secilin nxënës në veçanti;
- Lista të vazhdueshme (formative), të përgatitura paraprakisht, evolutive për çdo nxënës në veçanti, të cilat plotësohen pas aktivitetit të tyre konkret, e cila është specifike (pozitive ose negative) ose studime të rastit në të cilat mësimmshënësi e vëren gjendjen faktike;
- Instrumente që kanë të bëjnë në secilën lëmi programore në veçanti dhe në të cilat mësimmshënësi fut **të dhënat e të arriturave të nxënësit në të gjitha aspektet zhvilluese** të cilat nxiten me programin e shkencave natyrore (aspekti kognitiv-intelektual, socio-emocional dhe psikomotorik). *Listat evolutive kryesisht kanë të bëjnë me objektivat të cilat në tërësi arrihen në nivelin e klasës së parë dhe nuk janë kalimtare për klasat më të larta.*

VLERËSIMI MIKROSUMATIV - Në mbarim të tremujorit të dytë, në bazë të njohurisë së vlerësimin formativ, realizohet vlerësimi mikrosumativ.

VLERËSIMI SUMATIV - Në bazë të të dhënave të përgjithshme të fituara nga ndjekja dhe vlerësimi formativ mësimmshënësi e konstaton (përshkruan) gjendjen zhvilluese të secilit nxënës në veçanti, në suaza të secilës lëmi programore.

ARRITSHMËRIA DHE ECURIA E PËRMBLEDHJES SË DËSHMIVE

- Për përmbledhjen e dëshmive gjatë një viti duhet të kenë qasje prindërit që të mund të kontribuojnë në realizimin cilësor të mësimit nga lënda e shkencave natyrore.
- Për notën përfundimtare analitike-përshkruese , gjithashtu duhet të kenë qasje prindërit dhe bëhet pjesë e përmbledhjes së dëshmive të nxënësit.
- Përmbledhja e dëshmive e nxënësit me të dhëna të pastruara dhe të përzgjedhura vazhdon në klasën (më të lartë) vijuese.

MËNYRAT E KONTROLLIMIT DHE VLERËSIMIT – Në pajtim me natyrën e programit të shkencave natyrore në klasën e parë, kontrollimi dhe vlerësimi përshkruar duhet të realizohen me shkrim, në mënyrë praktike, përmes prezantimit, aktiviteteve dhe ushtrimeve përkatëse.

4. Kushtet hapësinore për realizimin e programit

Programi sa i përket kushteve hapësinore për realizim bazohet në Normativin për hapësirë për klasën e I, II dhe III dhe në mjetet mësimore për klasën e I miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës.

5. Normativi për kuadrin mësimor

Mësimdhënien për shkencat natyrore në klasën e parë mund ta realizojë:

- Profesor i mësimit klasor;
- Profesor për edukim parashkollor;
- Pedagog i diplomuar.

Nënshkrimi dhe data e verifikimit të programit mësimor

Programin mësimor për shkencat natyrore për klasën e parë në arsimin fillor nëntëvjeçar, marrë dhe lejuar nga Qendra Ndërkombëtare e programeve mësimore (Cambridge International Examination) dhe përshtatur nga Byroja e zhvillimit të arsimit, e caktoi

më

Ministër

Spiro Ristovski